

GJUHA E QËNDRËS UNIVERSALE

Sokrat **HANAJ***

HYRJE

—
Asgjë nuk mund të jetë në qetësi absolute, gjithçka lëviz, gjithçka është në një ndryshim marramendës dhe kjo, në formën e një ngatërrese më të madhe, ndodh tek mendimet e vetë njeriut, që asnjëherë nuk gje-jnë qetësi. Rryma e Qëndrës, si përqëndrim ekstremesh, imponon PËRPLASJE MARAMENDËSE IDESH.

Diku unë shkruaj: “Thotë pasqyra – o njeri, unë të njoh dhe ti e di, veten tënde nuk e njeh, vetëm unë të them kush je”. Dhe kulmi i ngatërresës, sipas mistiçistes Blavatski, është kur njeriu i shkatërruar nga jeta, thyen pasqyrën sepse ajo i tregon shëmtinë e fytyrës dhe me pasqyrën, në këtë rast, Blavatski identifikon veten e saj. Ndodh si me bishën e cila i vërsulet egërsirës të saposhfaqur mbi pasqyrën që ka para vetes. Ar-syeja o njerëz, është mosnjohja e vetes.

Fenomeni i njohjes ose i mosnjohjes së botës sonë, apo edhe i vetes sonë, është një ngatërresë pa fund, që përpunohet në trurin tonë, pas informacioneve TË PAPLOTA, të cilat i marrim me anë të shikimit dhe të dëgjimit, duke ndërtuar mendime që zbërthehen vetëm me anë TË GJUHËS, me ndihmën e fjalëve, formulave, simboleve, gërmave, numrave etj.

Por, siç shpjegoj më poshtë, vetëm dy gërma, kanë kuptime pambarim, që nga Krijuesi dhe deri tek fenomeni i krijimit, kështu që, ndërthurja dhe formësimi i ideve dhe mendimeve tona bëhet aq marramendës (prej kombinimit të gërmave, numrave etj) sa që merr përmasa BIBLIKE, deri tek fenomeni I KULLËS SË BABELIT, trajtuar mrekullisht nga PETRO ZHEJI, deri në gjetjen prej tij TË GJUHËS UNIVERSALE, pra të gjuhës MESIANIKE.

Për të shtruar rrugën në drejtim të kësaj teme, po citoj P. Zhejin kur thotë se “Të vërtetat universale ndodhen në ç’do pikë të Universit” dhe mua, për këtë, më duhet të shtoj që secili prej nesh, PËRFSHI VETEN TIME, pasqyron vetëm të vërtetën e asaj pike ku ndodhet dhe jo të pikave të tjera, prandaj dhe është një detyrim I SHENJTE I GJITHSECILIT PREJ NESH, që të gjejmë tek njeri-tjetri, jo rrugët që na ndajnë, por ato që NA BASHKOJNË, për të mbërritur kështu NË VLERAT UNIVERSALE. Ç’do rrugë tjetër përveç UNIFIKIMIT, është një dështim, sepse, në çdo hap që njeriu hedh “... vështirësitë e kërkimit rriten, derisa intelekti më i thellë nuk mund të futet...në një mister të padepërtueshëm.” (“Baha’u’llah’u dhe epoka e re” f.264). Pra, për t’u plotësuar me vlerat universale, gjerbni ç’do pikë të IDEVE në Tokë.

GJUHA E QËNDRËS - SIMBOLI I PËRJETËSISË

Në kërkim të energjive të pastra për jetëgjatësi dhe mirësi, detyrohemi të rrugëtojmë në dy shina, në lë-mëndje dhe vëmëndje, si degët përmbi trung. Tek “Përballja me pasqyrën, filozofi apo mister”, f.32 kemi çmendurinë: “A do të kishe dëshirë të bashkëbisedoje me Perëndinë dhe pastaj këtë t’ia deklaroje botës, që

ajo të mund të përmirësohet”, ashtu si thënia tronditëse e Ajnshtajnit: “Gjetja e teorisë së gjithësishe, do të ishte e barabartë me leximin e mendimeve të Zotit”.

Por a mundet njeriu të dijë gjithçka dhe a mund të bëhet zot i vetes, kur përdor vetëm 1- 4% të trurit ?! Dimë (mbi 4%, RD 3.7.2013), zgjimin e gjigantit të fjetur ose sipas P. Zhejit: zgjimin e GJENDRËS PINE-ALE. Ç’është kjo energji e fjetur ?!

Unë, në librin tim të parë dhe në emisionin “Enigma”, them: “Dajo, unë po të dua ushqehem vetëm me ajër”. Dymbëdhjetë vjet më pas u bë fakt I PRANUAR SHKENCËRISHT. Gjithë energjitë: natyrale, industriale, alternative, pozitive, negative, efekte anësore, droga, çajra etj, janë pjesë e një zinxhiri marramendës të raportit SHKAK-PASOJË, të misterit: “GJITHÇKA = -- ∞ + ∞ = 0”?! Çudi pra që GJITHÇKA = HIÇ.

Në filmin “Klon”, Albieri, tek SFINKSI i piramidës së GIZES thotë: “O do të zgjidhim enigmën e jetës, o do të zhdukemi”. Sfinksi është mbretërimi marramendës i të kundërtave (☆).

F.2

Çelësat e zgjidhjes së mistereve sipas B Blushit janë:” ...një numër dhe një gërmë”.Numri simbolizon botën e dukshme, që ndahet, coptohet dhe numërohet, ka sasi; gërma simbolizon botën e padukshme që vetëm mendohet, kuptohet, ideohet dhe vlerësohet nëpërmjet gërmave, pra ka cilësi. Që do të thotë se krijimi është sasi plus (+, kryqëzuar, martuar me) cilësi.

“...zberthimi i gjuhës na lejon të gjejmë atë thesar të pashtershëm diturie UNIVERSALE e të pavdekshme, që të parët tanë na e përçuan e na e lanë trashëgim” (Petro Zheji “Roli Mesianik i shqipes...”f.487).

Edhe Sfinksi i Gizës e fsheh misterin brenda gërmave. SFINKSI+GIZA (gji-za) = nis fiks GI+ZA. Gi + za = gjini + za (zëri; zë-nis, zë-kap -NGJIZ, krijoj). P. Zheji “Libri i aforizmave”: “zani zuni... zëri, fjalla i bëri të gjitha e pra edhe ajo e vetëm ajo të gjitha do t’i shpjegojë (f.209). Zanie = lidhje, burgosje dhe konflikt”. (f.245). Duke studjuar P. Zhejin, mbrin tek ideja se krijimi është një krim, izolimi I ZOTIT.

Pra LIDHJA UNIVERSALE është një IZOLIM, prangosje, burgosje E PAFUNDËSISË = ZOTërim MUNDËSISH, Perëndi, PëR(M)’E-NDI, ndijim, impenjim, FAMILJARITET, familje, MARTESE, KRY-QËZIM. Kjo do të thotë që UNIVERSALJA (-- ∞ + ∞) = PERËNDI (zero, e padukshme, e pakapshme).

“Gjithë ekzistenca është energji,energji në lëvizje dhe shfaqja e saj është (NGJIZJA) grimca, materia.” (“Përballja me pasqyrën...” f.24), ose e thënë fiks : $E=Mc^2$ = kalimi i anasjelltë masë (\rightarrow \leftarrow) energji.

Pra kemi: GJINIA zë, ajo krijon, ngjiz, këtu nis fiks ajo, gjithçkaja, nis fiks shkaku i githçkaje,shkaku i të gjitha shkaqeve, martesë kozmike = nis fiks NGJIZJA femër + mashkull = dy ORGazma (☆) = një ORGANIZëm dy-gjinor = embrioni i ri, KRIJIM.

P.sh. krijimi Biblik = ADAM = A+DAM (P.Zheji : është i ndam, i ndarë, jo e tëra = pjesë e së tërës, krijim, i krijuar). Më tej krijimi fizik, sipas shkencës = ATOM = AT+ (m)OM = (AT = AD,si TEO= DEO = AT, ZOT) + (OM = AM = ËM = MOMA, MËMA) = AD+AM = ADAM = AT+MAM = AT + MOM = ATOM, ose më tej ADAM = ATOM = AT+ MOM =AT+ EVA (Eva biblike ishte i njëjti trup i Adamit).

Sipas teorisë së relativitetit të A. Ajnshtajnit dhe P. Zhejit kemi: trupat, lëndët, grimcat, ngjishen me vërtitje duke marrë mbi vete hapësirë-kohën dhe flasin me “gojën e tyre”: “Unë jam grimca e Zotit”, “unë

jam pjesë e pjesës që në fillim një e tërë ish”, u bëra atom, mëmë dhe at, riprodhova një jetë, e quajta QELIZË, lat. CELLULA, “Dhomë e vogël”. “Roli mesianik...”: “cella, qeli, it. Cielo, qiell dhe cello, kall, fsheh” (f.176), shq. qeli, “dhomë burgu”... për tërësinë e informacionit e ndijimit, ngjeshur aty si në celular (celul+ar, dhoma e Zotit). Nadir Mura: “...Ne nuk jemi gjë tjetër veç RIPËRTËRITJE E ENERGIJË SË UNI VERSALE, ZOTIT...”.

Nga informacionet në internet, piramida e Keopsit ruan diturinë e një qytetërimi të mrekullueshëm, në qendër (+) të sip. së Tokës. P. Zheji në “Roli mesianik...”: “Qendra është një vrimë, (varrezë), vërë = Zoti, e vërteta {vërë(o)+ teta (∞ , infin.)} (f.179). Është Hyjnia, Zoti = zero, vendi i të vdekurve” (f.175). “Tomor, hebr. = vendi i të vdekurve” (K. Kovi). Pra Qendra qëndron (ekuilibër) ajo që ndërron (rotacion, riciklim, përjetësi) = $-\infty + \infty = 0$, çon në idenë e qëndrës gjenitale (GIZA) dhe kërthizës (m.TOMORIT).

Në “Njeriu vitruvian” i Leonardos, qendra e njeriut në rreth (shenjtor) = kërthiza (mendo mali i Tomorit), dhe e njeriut në katror (materialist) është organi gjenital (mendo GIZA). Dije të ndryshme rreth misterit të QENDRËS (Pitagora, Leonardo, Ajnshtajni, Fibonaci, mitologji, egjiptologji, S. Guri, NASA, Papa Françesku, P. Zheji) na çojnë tek përqëndrimi energjisë së hapësirë-kohës, si penetrim gjinor i tyre. KRIJIMI = KRY (kokë, fillim, që nis, penis) + HY-MJE. P. Zheji “Libri i aforizmave” kemi: “persisht KAR, shqip KRY (kaptinë, kokë), KRYerje, KRIjoj, KRim, KRejt (f.240) dhe te “Roli mesianik...”, “Në shqip HYU, Zoti dhe hyu, ai që hyri, u fut brenda... (f.176) ... hyu, ai që hyu (hyri)” (f.177). Krijimi është burgosja e Zotit = ZËRI, ZURI, ZE-U = JE+ZEU KRI+është = JEZEU KRIËSHT = JEZU KRISHT. Dhe fjala, mendimi = QYRAMENA (gr. Zoti Perëndi) shq. (k)QYRA (e jashtme)+M@ENA (e brendshme) = QI-

F.3

RJA (gr. zotëri) e MENIES (me-nie, ndjeshmëri, mendje, brendësi, që rri brenda), mbarsje e mendjes. Vet FJALA (KRIËSHT+ZEU, JEZEU KRISHT), që SKEP (shqep) (mit) TËRËN, siç thotë Petro Zheji, do t’i shpjegojë “në rolin e mesias” për “të rrëzuar kullën e ngatërresave gjuhësore, KULLËN E BABELIT”.

Nga lashtësia dhe Xh. Katapano, ATOM = i pandashëm, i lidhur, martesë, NGJIZJE. AT-OM = AT+OM = vet erosi, energjia krijuese. Pra atom = krijim = (z)eros, (zë, ngjiz) drejtë zeros ($\rightarrow 0, \leftarrow 0$), spermatozoidi drejt vezores = PENIS(je) në MI(t)TËR = të shohësh nisjen e misterit të së tërës. ATOM = nisja (baza), e strukturës së lëndës dhe energjisë. Anagrama ATOM = TOMA dhe sipas NASA-s: “... të dhënat e fundit... për malin e TOM(A)orit... nënkuptojnë aty zanafillën e jetës tokësore dhe fundin e njerëzimit njëkohësisht...” (“Telegraf” 22.8.2014). Pra, energjia atomike dhe konkretisht formula $E = Mx C^2$, (kalim i anasjelltë energji-masë) pranuar edhe nga feja (dëshmitarët e Jehovahit) dhe mistika (P. Zheji) na shërben si një mundësi zbulimi por edhe ngatërresë rreth misterit të KRIJIMIT, si më sipër, sepse :

Në “Kodi i Da Vinçit” e botimet pro e kundër, misteri që lëviz botën, GRAALI I SHENJTË, kodifikohet si “MONA L’ISA (ISAI = i dërguari i Allahut), “Lulja e LISIT” (BYLIS, BALLIS, BALLshih, HEKAL = Arka E NOES, NJOHAKASTRA, FARA E PËRJETËSISË), si “SOL-ANIMA” (dritë-hije) etj, na kujton “DY LISAT E VARREVE”(njëri me lënde, tjetri jo, simboli “SOL-ANIMA”, “LËNDË-SHPIRT”). Dy lisat (Bylis) kapën “majën e piramidës” Lavdan (L. Muhaj: Lavdan = leu nga dheu, doli mbi dhe, e for-

mës së prerë, ndan lajv), lat. Lawsdeo, lavdia e Zotit, arab. BAHA'U'LLAH, me simbol një "B"- arabe + dy yje pesëcepësh, B+YLLSI = BYLLIS. Tek Braun "Simboli i humbur", Lawsdeo = Lavde oroborosit, gjarpëri që sundon botën). Po aty... Të dy lexojmë biblën ditë e natë, por ti lexon "E ZEZE" ku unë lexoj "E BARDHË", dhe... "Kodet magjike": "gjarpri i madh i kopshtit të Edenit e Kryezoti janë të njëjtë". Prandaj fjala zgjon shenjtërinë ose bishën njerëzore, e kushtëzuar kjo nga sasia dhe cilësia e informacionit.

Shohim nga MISTIKA, prej PAPA Françeskut: "Zoti...ju ngriti lart mbi krahë shqiponje..." ("Mapo" 22.9.2014) dhe F. Demi "...krahët e shqiponjës i duhen njeriut që të mund të ngrihet në hapësirat më të larta të dritës" ("Republika" 15.5.2012), dhe se SHQIPJA (shqiponja, gjuha, atdheu) janë ALFA (α = syri) dhe OMEGA (Ω = truri) për njerëzimin, kundër mosmarrëveshjeve gjuhësore (nënkuptim nga "Roli MESIANIK ..." I P. Zhejit). Ajo është "gjuha KOZMIKE" sipas A. Dalipajt ose "gjetja e teorisë së gjithësisme (për gjithçka, ABSOLUTE)...e barabartë me leximin e mendimeve të Zotit", sipas A. Ajnshtajnit.

Fjala magjike e "teorisë së gjithësisme", si: "të dish për të gjitha gjërat" apo "midis tërë anëve", apo fiks: MEDITERANE (!), është një dilemë marramendëse me esencën e saj, si "mjet informimi i tërë anëve", "GITHËDITURI", ashtu si meditimi është çuditërisht një mundësi pa fund diturie dhe energjie, mbas kalimit të ndërjegjes në HIÇ (0, qendra, Zoti), edhe mediterane (MESI I ... midis tërë anëve, midis dhe-rave mbi oqeanë), është analogji e kuptimeve: ME DI (dije, mendja dhe medja, qendër informimi) + TËRË ANËT (midis tërë anëve), pra EPIQËNDËR MENDIMI DHE ENERGJIE, KËRTHIZA e BOTËS.

Qendrat energjike, truri kuantik, gjendra pineale, (BALL-SHIH), kërthiza, gjenitalet, kanë një analogji të çuditshme me Bermudet, m. e Tomorit, piramidën e Gizës, ku fuqia e mendimit, shpirtit, përmasat e penisit, teorikisht dhe praktikisht fokusojnë misterin ATLANTIDË = AT-LAND-IDE, shkak-pasojë-ndijim. Mediterane = qendër e sipër kontinenteve, por edhe ujërat në mes të dherave (tokës). It. tera, tokë, dhe(u). Në anagramë tera = ter, tendos, tiro, mungesë lirie, LIDH. Më tej TOK, me u tok, shtrëngim duarsh, bashkim, familjaritet (☆), shoqërizim. Por DHE, EDHE, plus (+), andej edhe këndeje, (krahët e kryqit, +), për-krahje, mbështetje, ndihmë, dhuratë, dorovi, dodonë, donacion, ndihmë shtesë (+), SHKOP për me shku, (SKOP-JE, SHKUP), SHKOPI (magjik) i Zeusit, SKEP(tër). L. Muhaj: shkop, me shku, shkoj, shko-shok, soc, deri tek SOCIOLOGJI.

Analogjia sceptër, skepudar, shqephtar, skipatar, skiptar, fokuson tek rrënja SKEP (scep ose pa cepa) +

F.4

SKIP (scip ose pa cipë). PA CEPA = i heq cepat, scjep, skjep, sqep, shqep, zbërthej dhe PA CIPE = heq cipën, zhvirgjëroj, zbuloj. Pra e gjitha nënkupton: zbërthej, thjeshtoj, zbuloj, na çojnë tek SKIPA (shqepa) TAR (tërë) = shqiptar. Dhe PE TRU ZEU (me lexu Zotin), shqep tërësinë e ngatërresave, rrëzon kullën e Babelit, me "Rolin mesianik...". SKEP me SKIP ose shqep me shqip = thelbi pa mbulesë, mall pa shtjella, MALL (PA)KASTRA, ose (jo)MALLAKASTRA, MALL jo në KESHTJELLË, pa kastro, pa mbulesë, pa mbështjellje, pa KOD. Pra, MALLAKASTRA, malli i Kastriotëve, përbën "thesare magjike" (nga E. Durham), pra thesare të koduara, pikërisht tek emblema e tyre, shkybe me dy krerë (B-YLIS, dy yjësi, dy ide, dy shpirtra, dy frymë,) + Ylli i Davidit [AT (m) OM = femër + mashkull = dy shpirtra]. P.Zheji "Roli me-

sianik...”: “Në orakullin e Dodonës LISI ishte Fryma e Zeusit, zotit pagan” (f.245), E. Kocaqi: “fillimi i koncepteve filozofike hyjnore”. LIS = L (lidhja e horizontales + vertikalen, $\rightarrow + \uparrow$, kryq, bashkim, kryqëzim, martesë) + I (“i”, orgazmë mashkulli, QIRiri i ndezur, ndriçues) + S (Triniteti,tërësia, ∞) = kryqëzimi i dritës (vlerës, idesë) MATERIALISTE me atë SHPIRTËRORE. Terminologjia pagane JEHOSHUA (Jezus) CHRISTES (Krisht) e zotit suprem ZEUS (Blavatski), dhe Zhejit: ZEUSI mishërim i zotit pagan, na pozicionon tek BY-LIS = DY LISA (L’ISA, ISAI në Kur’an: i dërguari i Allahut), kryqëzimi i dy dritave, dy dijeve, e shikimit (horizontales, \rightarrow) + e mendimit (vertikales, \uparrow), dituria më e plotë, MEDITERANE, GJITHËDITURI, martesë e të kundërtave, YLLI I DAVIDIT, arka e Noes. LISI = FRYMA E ZEUT ndërsa DY LISA (BYLIS) janë DY FRYMËRA, MATERIALISTE + IDEALISTE = HYJNORE...PRA :

NASA beson: “...m. Tomorit...(është) zanafilla e botës tokësore (alfa, α , A, syri, evoluimi fizik) dhe fundi i njerëzimit” (omega, Ω , truri, evoluimi ideor) (“Telegraf” 22.8.’14); Nostradamus:“Shqiptarët nuk kanë luajtur gjithë kartat... ata do ta habisin botën” (“Standart” 29.11.’10) dhe MARRAMENDJA: “Nga Shqipëria mund të lindë një profeci e re paqeje...” (Papa Françesku, “Mapo” 7.9.2015) kur pikërisht nga Shqipëria vjen FUNDI...: “Jemi në MBARIM... ky është një PROFETIZIM ... mbështetur në urtësinë MARRAMENDËSE të gjuhës. Njerëzimi po shenjtërohet, po piqet...” (P. Zheji “Roli mesianik ... f.361).

GJUHA E QENDRËS KRIJUESE--SHQIPJA

Tetor 2018

SHKAKU FILLESTAR ose SHKAKU I TË GJITHA SHKAQEVE është e njëjta gjë edhe po të themi se është vet burimi i lëvizjes dhe burimi i krijimit të gjithçkaje që shikojmë dhe të gjithçkaje që mendojmë. Është diçka jo konkrete, e pakapshme për llogjikën njerëzore, nocion abstrakt, një kombinim marramendës i luftës e unitetit të të kundërtave, një raport ekstremisht i pabesueshëm midis shkatërrimit dhe rindërtimit, midis barbarisë dhe ekstazisë, një raport ekstremisht i pabesueshëm i botëve pa mbarim, absolutisht të ndarra me njëra-tjetrën por... njëkohësisht edhe absolutisht të lidhura me njëra-tjetrën. Është një raport marramendës midis PAMUNDËSIVE EKSTREME dhe ABSOLUTISHT të MUNDSHMET. Sa e vërtetë është kjo ?!... MATEMATIKISHT PO, 100% E VËRTETË d.m.th. -- $\infty + \infty = 0$, që do të thotë se GJITHÇKA = me HIÇ dhe HIÇI = me GJITHÇKA, ose (kuptimi dhe vetë qëllimi i ekzistencës) dy BOTË TË KUNDËRTA (me luftën dhe unitetin e tyre) TË ÇOJNË NË HIÇ OSE NË GJITHÇKA. Shkalla më e lartë e krijimit, në konceptimin tonë njerëzor, është vetë pika kulmore e funksionimit të aftësisë së njeriut e, brenda tij, “TRINIA E SHENJTË” e tij. Kjo do të thotë: ATI = shkaku i krijimit, organet GJENITALE femër-mashkull; BIRI = i mbiri, fidani, KËRTHIZA; SHPIRTI I SHENJTË = ndriçimi shpirtëror i njeriut, çlirimi i tij nga “kthetrat” e dy hemisferave të trurit (materialiste dhe idealiste), zgjimi i gjendrës PINEALE.

Gjuha e qendrës, pra, s’është gjë tjetër, veçse energjia e HIÇIT dhe e ZEROS (0) por gjithashtu edhe e-nergjia e GJITHÇKAJE (infinite), është ENERGJIA UNIVERSALE E KRIJIMIT. Kjo energji është shka-ku i shkatërrimit dhe rikrijimit për gjithçka dhe në gjithçka, deri edhe në humbje apo përfitime shëndetëso-

F.5

re ose jetëgjatësisë së vetë njeriut , në varësi të marrëdhënieve që njeriu krijon NË RAPORT ME ‘HIÇIN’.

Eshtë një përfitim gradual, i vazhdueshëm, si me “pikatore”, që rrjedh prej energjisë më të pastër të mundësuar nga “TEORIA E GJITHËSISHME” (ABSOLUTE). Ky përfitim mund të sigurohet privatisht (intimitet) ose në grup. Kjo teori mund të çkodohet me dy çelësa, ai i mendimit (esenca, thelbi, cilësia, GËRMAT) dhe ai i shikimit (masa, vëllimi, sasia, llogaritjet, NUMRAT), që të çojnë në dy burime, drejt fjalës “SHQIP” (tepër e pabesueshme) (!), si edhe drejt formulës $E = M \times C^2$, si pragu (M)UR... i dy botëve, si MESIA I ENERGIJË që shkakton TRANSFORMIMIN MARRAMENDËS.

Fjala “SHQIP”, ashtu si gjithçka në univers, është e përbërë, e strukturuar, funksionale. Gërmat aty, si njëri prej dy çelësave çkodues (tjetri çelës, numrat tek $E=M \times C^2$), janë pjesë përbërëse e vetë fjalës, por janë edhe simbole, që do të thotë se duke zbrëthyer kuptimin e çdo gërme në veçanti, arrijmë të çkodojmë funksionin e fjalës. Duke u mbështetur edhe tek: “Sekretet e numerologjisë”, po zbrëthejmë:

S=SH, pasqyron Trininë e Shenjtë (plotësimin në shkallën më të lartë), principin e KRISHTIT: “Unë jam rruga, e vërteta dhe jeta” (f.97,98,99), që përbën misterin ATI-BIRI-SHPIRTI I SHENJTË ose e thënë ndryshe SHKAK-PASOJE-NDIJIM, si një mundësi marramendëse krijimi.

H= Ndërlidhja e vëzhgimit me intuitën, ndriçimi i shpirtit, përmbushja (f.150,151). Ndërlidhja kontraktore e dy shinave të përjetësisë, PINEALJA.

Q= “Martesa mistike”, jo seksuale por e vetëdijes sonë me Zotin (F.155) gjenitale femërore, hymja e Hyjnisë deri tek spermatozoidi në vezore ($\rightarrow \circ, Q, q, \rightarrow$).

I = Grep peshku, zgjimi shpirtëror. I = J = Y = JOD (“i”), qiriri brenda qenies sonë (f.160 ,161). Jod është mashkulli, pika e QENDRËS së VËRTETË TË DRITËS, Zoti brenda nesh (f. 162). Gjenitale mash-kullore, KOKË, dalje në dritë, orgazmë, KRY (në krye, në fillim dhe kry-ej, kryerje), KREU (kryesori ose kreu aktin), KRYerje, KRI(ë)SHT, KRISHTI, i mbërthyer në SHTYLLË (sipas dëshmitarëve të YHV).

P= Organi që shpreh mendimin kontraktore (f.145), njerëzorja (gjysmë- sferat e trurit), A(n)DAM, N(d)IERI, (m’e)NDJE, MENDIM+NDIJIM=NJERIU.

Po aty: SH = Trinia e Shenjtë, AT-LAND-IDE, MENDIM-LENDE-NDIJIM, zgjimi i GJENDRËS PINEALE. QI = “MARTESA MISTIKE”, riprodhimi, ku vezorja dhe sperma bashkohen për ENERGIJË NË KRIJUESE (f.161) është në vetvete kry-hymje, KRI-HIM = KRIJIM = AT+(m)OM = ATOM ose i pandashëm. IP = hip, hipje, ngritje, zhvillim, evoluim, E (është) + VOLI (përshtatje), është mbijetesë.

Gjithashtu: origjina SC(k)IP [ku C = pasuri, cilësi, thelbi (f.109) është pa kashtë, pa guackë, çarja = ÇAJRA, esencë dhe K = kundërshtitë natyrore (f.102)] = negative + pozitive = femërore + mashkullore ose Ylli i Davidit (☆), është NDËRVEPRIMI UNIVERSAL.

Edhe konceptimi SKYPE(skajp)= shqipe, shqiponjë, SHKY-BE (bën shqyerje). Bibla për fundin e

bo- tës: "... perdja e tempullit U SHKY...", P. Zheji: "...fundi i botës...", "...zbulimi i misterit...", "...heqja e vellos..." = shqyerja e "PERDEVE" ndarse, RËNIA e PENGESAVE = KOMUNIKIMI PA FUND, KO-MUNIKIMI ABSOLUT = ndërveprimi UNIVERSAL, ndërthurje e dy botëve të kundërta, MARTESË, PENETRIM, ÇVIRGJËRIM.

Përfundimisht fjala "SHQIP" do të thotë: RRUGA E VËRTETË DREJT PLOTËSIMIT UNIVER- SAL, MARTESA MISTIKE E TË KUNDËRTAVE, ☆, fara e përjetësisë, Arka e Noes, ALB-ANIA, fryma e Zeut. "Z = emri i babait të gjithçkaje të gjallë, ZEUT. Z = fundi i mistereve = ZOTI" (f.158,159), ZË, NGJIZ, KRIJON = ZANAFILLA. Për më tej, esenca është ENERGJI E PASTËR, HYgen (ZOTI në gjak), SHËNdet (shenjtëri pa fund), mjekësi (ME DI CINE = midis ÇAJRAVE), ESENCA E LËNDËS (kujto "lënde lisi", "Lulja e Lisit", LISI = FRYMA E ZEUT) = BYLIS, DY FRYMË = ☆, NDËRVEP- RIMI I ANASJELLTË UNIVERSAL.

F.6

Po ashtu edhe formula $E = Mx C^2$ është kalimi i anasjelltë energji-masë, valë-grimcë apo elektricitet magnetizim, fenomene këto që kushtëzohen nga QENDRA e NDËRVEPRIMIT të NDËRSJELLTË, kushtëzohen nga zona (M)UR... MIDIS DY BOTËVE, që lidhin dhe ndajnë (ÇAJNË, ZHVIRGJËROJNË) njera-tjetrën. Mendoni "PENETRIMIN" femër-mashkull të një spine që rrëshqet në brendësi të prizës elektrike dhe në momentin që ne do e "shkulim" nga priza me një shpejtësi marramendëse, aty do të kishim një "qark të shkurtër" të shoqëruar me një "krismë arme", pra një ndërveprim elektricitet-magnetizim.

Përfundimisht universi është një lidhje energjike "dykalimshe", kontradiktore, midis hapësirë-kohës, të dukshmes dhe të padukshmes, sasisë dhe cilësisë, negatives dhe pozitives, së mirës dhe së keqes, Relatives e Absolutes, fizikës klasike dhe kuantike, femërores dhe mashkullores etj. Pra ekzistenca është paradoksale dhe si zonë (M)UR për materializmin mund të jetë formula $E = Mx C^2$, ndërsa për idealizmin mundet të shërbejë botëkuptimi në "SHQIP", si dy çelësa për zbërthimin e misterit AT-LAND-IDE dhe kalimit nga masa në energji dhe nga energjia në masë. P.sh. tek shprehja: "BALLKANI (shqipja) FUÇI BAROTI" identike me $E = Mx C^2$, si FUQI BERTHAMORE, shqipja ndihmon në kontradikcionin AT + (m) OM si konceptim familjar (i PANDASHEM), femër + mashkull, fara e përjetësisë, ARKA e NOES, AL- (b)ANIA dhe jo si konceptim "pozitive-negative", të ndarjes dhe kundërvenies. Pra NDODH KËSHTU PËRMBYSJA e MADHE, ku lufta e të kundërtave kalon në formën e UNITETIT të të KUNDËRTAVE, d.m.th. jo më konceptet "negative--pozitive" por ato "femërore--mashkullore", ose "DUAJE ARMIKUN TËND". EPOKA E RE ËSHTË EPOKA E PLOTËSIMIT TË DY GJYSMAVE NË NJË, OSE HARMONIA e DY BOTËVE TË KUNDËRTA NË NJË, ËSHTË MARTESA E TË KUNDËRTAVE, pra ËSHTË ARKA E NOES, është rruga e shpëtimit, ËSHTË ROLI MESIANIK (I SHQIPES).

GJUHA E QËNDRËS KOZMIKE

-NIBIRU- EPIQËNDËR TURBULENCASH PËR BOTËN KONCEPTUALE (3.11. 2016)

(Ky material i referohet shkrimeve që qarkullojnë në internet, për atë që quhet planeti i 12-të).

Ai i afrohet Tokës një herë në 3600 vjet. Gjatë dy periudhave të fundit “planeti i ZOTIT” (“i dërguari i Zotit”), ka kaluar midis Marsit dhe Jupiterit, pika më e afërt me Tokën, rreth 7200 dhe 3600 vjet më parë (ose hera e fundit në v. 1628 p. Krishtit). 7200 vjet më parë fenomeni u quajt “PËRMBYTTJA E NOES”. Në librin tim “Përballja me pasqyrën...”, f.12, kapitulli “NJOHAKASTRA” (ARKA E NOES), ndërtohet një analogji e çuditshme e qytetërimit të lashtë HEKAL-BYLIS si një Arkë e NOES, ku HEKAL shkon si HEQ-AL = DRITA HYJNORE dhe BYLIS rri si DY-YLLËSI, DY VATRA DRITE.

Shkrimet në internet vijnë se Nibiru është shkaku i vërtetë i ndryshimeve dramatike natyrore, fizike dhe psikologjike mbi Tokë. Autori shkruan për vizitën e tanishme të “planetit të Zotit”, të “planetit të Kryqit” apo “atij të Gjykimit” duke besuar se një edukim psikologjik i racës njerëzore është në zhvillim.

Pra, kush është ky “GJYKATËS APO MËSUES KOZMIK”, i quajtur Nibiru dhe vjen me misionin “ME ZHBIRU” gjendjen tonë. “Nibiru” e quanin Shumerët, që nënkuptonin “planeti që kalon”, vizitor ose “turist” dhe “vëzhgues”. Sipas shpjegimit tim, tek tema: “Fjala si energji shkatërruese dhe rindëtuuese”, kuptimi i gërmës shqipe “ZH”, planetit të Zotit “ME ZHBIRU”, i jep kuptimin e “Birit të Zotit Zeus”, të Zotit të FJALËS.

Në Babiloninë e lashtë e quanin Marduk, mbreti i qiejve, ndoshta në kuptimin SHQIPONJË. Çifutët e quanin “glopi me krahë” (ndoshta në shërbim të Atlantit apo në zbrëthimin e misterit AT-LAND-IDE ose shkak-pasojë-ndijim). Gekët e quanin NEMESIS që shqip tingëllon si NË MES, ndërmjetës e MESIA. Në Antikitët është quajtur edhe si planeti i Zotit apo “planeti i Kryqit” që tingëllon si NI-BIRU I ZOTIT DHE I KRYQIT, pra BIRI I ZOTIT NË KRYQ, pra në kuptimin e JEZUSIT.

F.7

Nga profetët është quajtur si mesazheri përvëlues (apo si radikal) dhe “kometa e Gjykimit” (ndoshta si ka+meta, ka+mitin e gjykimit). Pra vjen si gjykatës për botën, gjykim ky që përforcohet sipas kalendarit të fisit MAJA që: “Bota e njohur deri tani s’do të jetë më, ose sipas P. Zhejit “Jemi në mbarim... ky është një profetizim...” dhe Papa Françeskut tek “Mapo”: “...nga Shqipëria pritet të lindë një profeci e re”.

Deri atëhere, sipas shkrimeve në internet, “Toka do të përjetojë një errësirë totale...” pikërisht kur Ni-biru do të kalojë (pas vitit.2012) midis Jupiterit dhe Marsit, që...të dy sëbashku luajnë me konceptin JEP- -TERR NE-ARSY.

Më pas, sipas Biblës, tek libri i fundit (shkruhet në internet) Apokalipsi / Zbulesat (21: 2,12,16), përmban detaje për “ERIS”, i quajtur ERIS/SALEM (salem = selam = lajm) ose JERUSALEMI i RI. ERIS tingëllon si ER+ISA, pra Era e Isait, Epoka e Re e Isait. ISAI në Kuran është profet (Jezusi), i dërguari i A-llahut. Më tej, thonë shkrimet, drita e tij YAHWEH/ANU-- është lideri i planetit të Zotit. A/N është drita e diellit (diell i dytë), por kuptohet është dritë për mendjen, çlirim nga errësira totale e mësipërme. “Edhe dëshmitarët e JEHOVAIT” deklarojnë që YHW, sipas tyre, është “AI QË SHKAKTON TË

BËRËT”, pra, shkak i fillestar, SHKAKU I TË GJITHA SHKAQEVE.

GJUHA E QENDRËS SI RRUGË SHPËTIMI

ARKA E NOES (Patos-Nëntor 2018)

Termi “Arka e Noes”, është në vetvete një mister marramendës, që nuk i lë shteg arsyes njerëzore për të zgjidhur dilemën e një të vërtete të padiskutueshme mbi misionin e vetë Arkës, i cili është: RRUGA E SHPËTIMIT. Misteri, dilema ose pyetja është: ARKA E NOES nënkupton një fenomen ose një zgjidhje historike, qoftë edhe APOKALIPTIKE apo është një “...TEORI E GJITHËSISHME...një BASHKEBISEDIM (i vërtetë) ME ZOTIN...”, siç e thotë A. Ajnshtajn ?

Atëhere ...?! RRUGA E SHPËTIMIT, në versionin biblik, nuk vjen si një premtim për rikthimin e mundshëm të Arkës së Noes, por si një RIKTHIM TË MESIAS NË TOKË. Dhe vjen “...midis REVE...” (...?! mungesa e diellit, përmendur më lart: “Toka do të përjetojë një errësi të totale...”) pikërisht atëhere shfaqet “ROLI MESIANIK I SHQIPES...”. Por... ?!!!

Kujdes ! ... Mjeku iu duhet të sëmureve dhe sigurisht që jemi në një situatë ku kërkohet “...Rënia e Kullës së Babelit”. Dhe aty, Kulla e Babelit, është ngatërresa e gjuhëve, ajo që sjell dhe ngatërresën e botës, e kundërta e paqes, që solli në fillimshtatorin 2015 në Tiranë, 4000 përfaqësues botëror për paqen. Ngatërresa rrezikon të çojë deri dhe në shkatërrime e shfarrosje, e varur kjo nga sasia dhe lloji i konfliktit.

Shprehjet konceptuale si Arka e Noes, ROLI MESIANIK e Kulla e Babelit, i përkasin “BOTES SE MENDJES”, që zgjidh ngatërresat dhe jo “BOTËS SË SYRIT” që i shkakton ato, dy botë këto të kundërta, me koncepte të kundërta si: “sheh mendja dhe jo syri”, apo: “ta shoh, pa ta besoj”.

Le të shohim një fakt shumë të thjeshtë, dy germat Z+E, që për syrin janë vetëm dy gërma, për mendjen janë në minimum disa kuptime: 1. Zë = zëri, fjala; 2. Zë = mbërthehet, ngjitet (me zamkë); 3. Zë = zuri, ngjizi, “u zu qumështi u bë kos”; 4. Zë = kap, e mbërtej në çark; 5. Zë = u zu pema, hodhi rrënjë, u zu shartesa 6. Zë = zë shiu, fillon të bjerë shiu; 7. Zë = i zë dora, ka shans, ka fat; 8. Zë = i zë vend fjala, zë mend, vë mend, zuri tokën, e pushtoi... etj. Por kemi edhe ZEJU, Ai që zuri botën, Zoti i zotave që ngjizi Botën, që krijoi gjithçka. Edhe vetë ZANAFILLA (krijimi biblik) është një anagramë: ZË+FILL (zë, nis, filloj). E pra, a mundet syri t’i rrokë njëherësh gjithë këto “pamje” apo “pikëpamje” sapo sheh dy gërma?

Prej vetëm këtij fakti të thjeshtë ne nuk duhet të jemi aspak indiferentë ndaj magjisë së FJALËS. Fjala meriton vëmendje sepse është jo si TULLA, por vetë TULLA që ndërton MENDIMET pambarim, ashtu si atomi (vetë struktura atomike), është BAZA e gjithçkaje që ne e quajmë materie. Duke u ndihmuar nga li-

i Jim Marrs “Kush e sundon Botën” (f.265) që arsyeja e njeriut është qiriu i Zotit, mund të përdorim këtë QIRI për ndriçimin e mendimeve njerëzore, në mënyrë që ai të mund të shohë “NGATËRRESAT E

PA FUND, NGA HIÇI TEK PAFUNDËSIA”.

Nga P. Zheji, në “Roli mesianik i shqipes...”, kemi: “...në fillim ishte fjala dhe fjala ishte Zot (f.171) në lat. DEUS = ZOTI (f.171)...dhe vëmë re se D-ja dhe T-ja nistore (si gjermë e parë) kthehet shpesh në Z” (f.278). Prej këtej do të kishim edhe kalimin nga Deus në Zeus dhe përfundimisht, që Fjala = Zot (Gjoni 1:1, tek P. Zheji) = Deus = Zeus e më në fund dalim në kuptimin: FJALA = ZEUS, ajo krijoi GJITHÇKA. (Zheji: “...fjala i bëri të gjitha...dhe vetëm fjala të gjitha do t’i shpjegojë”). E njëjta gjë ndodh me kalimet ADAM në AT+AM (at+mëmë), strukturë me dy gjini, për të mundësuar në LINDJEN e një pafundësie marramendëse shpirttrash, por e njëjta gjë ndodh edhe me strukturën me dy gjini AT+(m)OM, për të mundësuar në LINDJEN e një pafundësie marramendëse të lëndës në të gjithë Universin, por e njëjta gjë, IDENTIKE E NJËJTA GJË, është dhe në kuptimin e ARKËS SË NOES, ku FARA E GJALLË (dy gjini) e çdo forme të jetës në Tokë, ka mundësuar pafundësinë marramendëse të jetës që përjetojmë sot.

Është e çuditshme por me sa duket, edhe anagrama TOMA (rrënja e fjalës TOMOR), e strukturës dy gjinore ATOM, ka mundësuar të njëjtën gjë. Nga “Telegraf” (dt. 22.08.2014) po citoj: “E FSHEHTA e m. të Tomorit...NASA publikon të dhënat e fundit të lidhjeve midis Trekëndëshit të Bermudes dhe m. të Tomorit. Çfarë fshihet brenda tij dhe që vlen për njerëzimin...Sipas një ish-punonjësi të këtij institucioni (pra NASA-s)... mund të fshihet zanafilla e jetës tokësore dhe fundi (mbyllje e ciklit) njëkohësisht...”.

Është e çuditshme gjithashtu se një ushtri e tërë studiuesish, shqipfolës, por edhe jo, janë duke ndarë mendjen se zanafilla e gjuhëve të botës është ajo pellazge, gjuha e fillimit, gjuha e mbijetuar mbas PËR-MBYTJES SË MADHE, gjuha e “ambalazhuar” në ARKËN E NOES. Dhe...ideja se “një person mund të ketë takim të drejtpërdrejtë me Zotin, pa asnjë ndërmjetësim...” (D. A. Shugarts) dhe “...Arka e Noes, mjet komunikimi me Zotin...” (“Kush e sundon botën”) na jep mundësinë në njerëzve për kuptimin e këtij misteri. Tek “Simboli i humbur” (D. Brown) kemi: “Shkenca NOE-tike : porta moderne drejt urtësisë an-tike... greq.e vj. Nous – dije e brendshme, intuitive” (f.98,99). Sipas L. Muhaj: NOA në shqip do të thotë ‘njoh’, për numërorët, shkodranët: ‘njehi’; në gr. ‘anagnost’ = i panjohur ose tej kufirit të njohjes; angl. ‘aj now’ = unë di, unë njoh; it. ‘inkonjito’ = i fshehur, i panjohur. Gjithashtu Lirimi bie dakord me mua që NEOKASTRA (Elbasani i lashtë ose fara e së ardhmes) do të thotë NOE-KASTRA, NOE-ARKA, Arka e Noes, ARKA E NJOHJES ose NJOHAKASTRA, NJOHURIA E FSHEHTË, NJOHURIA E KODUAR, e fshehur thellë në misterin E GJUHËS.

Dhe çka njerëzimi e kërkon përjetësisht, P. Zheji e zgjidh përfundimisht: “...vetëm duke gërmuar the-llë e më thellë në misterin e gjuhës... kryekëput të gjuhëve të lashta...dhe jo aspak konceptuale e abstrakte të shkencës, së cilës i shpëton thelbi... (pra) me një gjuhë të thellë...UNIVERSALE...ne do të jemi në gje-ndje ta DËGJOJMË ZËRIN e QENIES (Supreme)...GJUHA është më afër QENIES se çdo gjë tjetër...(si) SHTËPIA e QENIES ” (“Roli mesianik i shqipes...” f.140,137). Më tej rishikojmë: “Arka e Noes...mjet komunikimi me Zotin...‘SHTËPI E MADHE’...‘HEKAL’ ” (“Kush e sundon botën”). Sipas ‘fjalorth bib-lik’: HEKAL, hebr. NDËRTESE E MADHE, SHTËPI E MADHE. Më tej Frensis

Bejken, tek “Atlantida e re”, ëndërron “...për të realizuar SHTETIN IDEAL (Parajsën) në botën politike” e “ajo që në Bibël shfaqet si PARAJSA, përputhet me KOHËN e MADHE të ARTË të historisë greke” (‘Mitet’ f.282). Përsëri P. Zheji: “Shën Pali: ‘mos harroni se trupi juaj është TEMPULLI I PERËNDISË’...Tempulli është kuptimi suprem i QENDRËS MISTIKE, SHTËPI e ZOTIT”, dhe D. A. Shugarts: “Nuk është fjala për një tempull të vërtetë...por një tempull i ngritur në mendjen tonë, me dhoma të fesë, filozofisë, shkencës...”.

Pra, as më shumë dhe as më pak, jemi fiks tek SHTËPIA E ZOTIT, SHTËPI E MADHE, TEMPULLI

F.9

I PERËNDISË, (“...në mendjen tonë...”), PËRMBI SUPE. Është pikërisht si thotë Isak Njuton: “Nëse unë kam parë larg, kjo nga që kam qëndruar mbi SUPET E GJIGANTËVE” (“E panjohura” 823).

Duke “shkallmuar” indiferencën e duke “përgjuar” gjigantët, na “heq osh” ‘ATLANTI’, “GJIGANTI I FJETUR TEK NJERIU” (“RD” 3.7.2013), që zgjon vëmendjen si më poshtë:

Fjalën ATLAS (sipas miteve dhe ATLANTI), e njohim shpesh, me pamjen e hartës së botës, e relievit të tokës apo të kufijve detarë, oqeanikë, kontinentalë apo shtetëror etj. Gjithashtu edhe libri, me pamjet apo format anatomike, le t’i quajmë ‘relievi’ i trupit tonë dhe organeve të tij, quhet edhe ai ATLAS, bile edhe ai na njeh me BOTËN (trupin tonë) ku jetojmë. Pra, ATLASI shërben njëkohësisht dhe si pragu... (M)UR mes botësh... sepse dhe midis zverkut e kokës kemi një unazë që quhet ATLAS. Pikërisht këtu misteri bëhet interesant, po të mendosh që PIKËRISHT KËTU ‘VJEN VËRDALLË’ ...edhe MITOLOGJIA...

Sipas Eskilit: “ATLANTI mban mbi supe polet qiellore” dhe më tej, tek “Mitet” f.54 kemi: “ATLANTI, ZVERKU i të cilit shërbente për të mbajtur QIELLIN, BANESËN E LASHTË TË PERËNDIVE...Atlanti njëherë mban Qiellin mbi KOKË...njëherë mbi SUPE dhe njëherë mbi QAFË”.

Duke iu rikthyer simbolikës së Arkës së Noes, na krijohet një lidhje mbresëlënëse: “AR-KA (sipas Sh. Musait) është AR+KA, me kuptimin ‘ajo që ka AR’, ‘ajo që mban AR-in’... dhe duke shtuar ‘NOUS = di- je e brendshme, intuitë (“Simboli i humbur”), do të kemi: AJO QË KA ARIN E NJOHJES. Por, kush e ka ARIN e NJOHJES ? Nën ndriçimin e P. Zhejit arrijmë në përfytyrimin marramendës se ARIN e NJOHJES e ka... ALBANIA. Tek “Roli mesianik...” f.152 kemi që: AR = AL = INTELIGJENCA HYJNORE dhe prej këtej do të kishim që: ALBANI = AL (Hyjnia) + BA (me ba, bërje) + NI (ndijim) = ZOTI + BËRJE + NDIJIM = AT + LAND + IDE (ATLANTIDE) = SHKAK PASOJË NDIJIM = ATI BIRI DHE SHPIRTI

I SHENJTË. Fiks këtu, tek Atlantida, çuditë nuk shterojnë: “Teoritë mbi kontinentin e humbur...SHQIP-TARËT PASARDHËS TË ATLANTIT ?!”, sipas gazetës “Standard” dt. 5.10.2015.

Si një rikujtesë e gjithë shkrimit rezulton: Gaali i Shenjtë, “Lulja e Lisit”(“Kodi i daVinçit”), Bylis, Ba-llis, BALL-shih, HEK-AL, Mallakastra, NJOHAKASTRA, ARKA E NOES, Parajsa biblike, Epoka e Artë, “SHTËPI E MADHE”, “SHTËPI E ZOTIT”... (në internet, mali i Tomorit, quhet ‘FRONI I PERË-NDIVE’); duket se janë reflektime të njera-tjetrës, burime prej INTELIGJENCËS HYJNORE TË

MALIT TË TOMORIT, si formë e farës së PËRJETËSISË, si fomë e INTELEKTIT ‘ALB’ në VARKË, pra ALB-ANIA, që mbart të koduar misionin e PËRJETËSISË. Rikujtojmë edhe njëherë: “NASA: ...M. TOMORIT ... ZANAFILLA dhe FUNDI I NJERËZIMIT...”, ashtu si në Bibël, ‘Zbulesa 8’: “Unë jam Alfa (α) dhe Omega (Ω), fillimi dhe mbarimi” thotë Zoti ... ashtu si fara është FILLIMI dhe MBARIMI i pemës. Kjo do të thotë që ç’do farë e fsheh bimën brenda kurse ç’do bimë e mbyll ciklin duke prodhuar farën e re, veç- se këtu kemi një FARË TË KODUAR, është FARA E INTELIGJENCËS HYJNORE, është ARKA E NO-ES. Gjithashtu çdo farë është fillimi i një bote të re, fillimi EMBRIONAL, është vetë KËRTHIZA.

Tek “Kodi i Davinçit”, f127, kemi: “Matni lartësinë tuaj dhe pastaj pjesëtojeni me lartësinë nga toka deri tek kërthiza...”. Raporti jep: $Fi(\varphi) = 1.619$ i cili njihet si raporti ‘FIBONACI’, e nga shumë studjues “PI-KANTË”, vlerësohet si “STRUMBULLARI I GJITHÇKAJE” ose si të thuash “me e sjellë BOTËN VËR- DALLË”, apo “EPIQENDRA E BOTËS”... P. Zheji tek “Shqipja dhe sanskritishtja” apo Dan Brown tek “Origjina”, e vendosin spiralen simbol të vargut Fibonacci, në kopertinën e librave përkatës, si “BALLA-FAQIM ME ORIGJINËN”. Më tej, në “Përballja me pasqyrën, filozofi apo mister ?!” f.89,90 gjejmë se qendra të ndryshme plot mister, si ▲ BERMUDEVE, BALLKANI etj. ndërtojnë raportin e Fibonacit në pozicionin që kanë me ekstremet gjeografike të sipërfaqes, apo të poleve të Tokës. Në studime të mëvonshme, kjo më rezultoi edhe si një raport i tillë midis malit të Tomorit dhe qendrave të rëndësishme e stra-tegjike, si edhe ekstremeve gjeografike. nga më të çuditshmet. Për më shumë mbi misterin e këtij raporti,

F.10

referojuni

librit “Kodi i da Vinçit”, për të kuptuar se një energji mister na tregon rrugën drejt Origjinës, ZANAFILLËS, e ngjashme me shprehjen e NASA-s: “...mali i Tomorit...ZANAFILLA dhe Fundi i njerëzimit”.

Nën këndvështrimin historik, rikujtojmë se “Besimi i Krishterë, s’ ishte gjë tjetër veç një zgjerim i besimeve helenike” (D.Shugarts) por...studuesit e gjuhës Pellazge, midis tyre dhe Mati Aref, argumentojnë se qytetërimi Helen është i prejardhur nga ai PELLAZG, kuptohet, duke përfshirë edhe kulturën fetare të ZEUSIT, Zotit të paganëve, ndërsa nga Blavatski kemi që JEHOSHUA (JEZUS) CHRISTES (KRISHT) është një terminologji pagane e ZOTIT SUPREM ZEUS. Duke shtuar idetë e studuesve, për Dodonën e malin e Tomorit, përfshi edhe Lirim Muhaj, përforcojmë idenë se Tomori është SHTËPIA E ZËRIT TË ZOTIT SUPREM ZEUS.

Por...ç’ është besimi i krishterë, apo terminologjia pagane JEHOSHUA CHRISTES ? Jezus: (Zbulesa, 22:13) “Unë jam alfa dhe omega, i pari dhe i fundit, fillimi dhe mbarimi...”, ndërsa teoricienët materialistë, Marks dhe Engels tek: “MBI FENË” shprehën: “... Alfa dhe omega e doktrinës së krishterë... është parimi << Një për të gjithë e të gjithë për një >>”, kurse ajo që vetë besimtarët e saj e quajnë FILOZOFIA HYJNORE, (feja Baha-i) teorizon: “<< Një për të gjithë e të gjithë për një >> është i vetmi parim mbi të cilin një bashkësi mund të lulëzojë” (“Baha’u’llah-u dhe epoka e re”). Ky është dhe parimi bazë për

“RE-NDIN E RI BOTËROR” të profetit të fesë Baha’i. (shih: “Baha’u’llah-u dhe epoka e re” f.351-362). Epo- ka e re, që përkon me mijëvjeçarin e ri, fillon fiks më 9.9.2000 ku “Samiti i 160 vendeve më të zhvilluara, në SH.B.A., firmos deklaratën tetë faqëshe...sipas parimeve për një epokë të re dhe për RENDIN e RI BO-TËROR” (“TVA” 9.9.2000 ora 20.00). Sipas Jim Marrs, tek: “Kush e sundon Botën?”, f. 468 kemi: “Pita- gora, i njohur për parashikimet e tij të sakta, mund të jetë i pari që parashikoi një REND TË RI BOTË- ROR”. Dhe për t’a plotësuar këtë ide, mbi “evoluimin e GJUHËS SË QENDRËS”, na jepet mundësia të kapërcejmë parashikimet e Pitagorës si më poshtë: “shkolla e Pitagorës...(ishte) një lidhje mistiko- fetare ...(që) vinte prej rrymës fetare ORFIKE, ME KULTURË PELLAZGE” (Ali Mollaj tek gazeta “Republi-ka”, 21.9.2006).

Dhe së fundmi, le të guxojmë pra e të themi se e gjithë kjo ENERGJI KRIJUESE, EVOLUTIVE, mbi burimin e mundësive jetësore, mbi burimin e forcave që e zhvillojnë dhe e përsosin jetën mbi tokë, duket se vjen PREJ SHKAKUT TË TË GJITHA SHKAQEVE, DUKE “BURUAR” PIKËRISHT NËPËRMJET MALIT TË TOMORIT.

Po e mbyll këtë material me idenë se nuk mbaron këtu sepse ky është vetëm një këndvështrim dhe si i tillë ka nevojë për një “shoshë” konceptuale, sepse dije janë dy, pro dhe kundër (di = dy), ndërsa njohje ka vetëm një(h).Shtoj gjithashtu rreth dijes, fjalët e Sokratit, filozofit të madh grek, i cili ka thënë:“Unë di atë, se nuk di asgjë”, përforcuar prej shkencëtarit të madh A. Ajnshtajn se “Gjëja më e pakuptueshme në botë, është se bota është e pakuptueshme”. POR...(sipas “Bashkëbisedime mbi të padukshmen”) , “nuk është e njëjta gjë të thuash: - ne s’dimë asgjë dhe: - ne dimë gjithnjë e më shumë”. Unë rikujtoj se rruga e ngjijtjes që: “ne (të) dimë gjithnjë e më shumë”, është, jo duke mënjanuar e luftuar dijet e njeri-tjetrit, por duke u harmonizuar me dijet e njeri-tjetrit, ashtu si një tablo e plotësuar nga bashkimi i pjesëve të veçanta, si një familje e madhe në ARKËN E NOES (NJOHURIA E ARTË), por me një emër më tokësor : RENDI I RI BOTËROR .

Përfundimi i materialit – PATOS, më 21.11.2018